



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës për informacion regjistruar me numër rendor 39 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me shkresën nr. 6549/1 prot., datë 22.12.2023, me anë të së cilës kërkon informacion mbi numrin e çështjeve të shortuara në rrugë manuale për periudhën nga viti 2018 deri në datën 22 dhjetor 2023, në të gjitha shkallët e gjyqimit, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës, si dhe ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është organi qeverisës i sistemit gjyqësor, por nuk është organ gjyqësor, ndërsa pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, sikurse përcaktohet në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i ndryshuar.

Sa më sipër, informacioni i kërkuar nga ana juaj për numrin e çështjeve gjyqësore të shortuara manualisht nga gjykatat, në kohën kur sistemi i menaxhimit të çështjeve nuk ka funksionuar, nuk zotërohet nga Këshilli. Në këto kushte, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, me shkresën nr. 6549/3 prot., datë 28.12.2023 ia kemi përcjellë për trajtim autoritetit kompetent, pra gjykatave të të gjitha shkallëve.

Duke iu falenderuar për mirëkuptimin,